



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 08.09.2026

MBLEDHJA Nr. 42,
Datë 11.09.2026, ora 09:00
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 59/2026, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 11.09.2026, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 42 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë "3X Energy" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga central fotovoltaike.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë "Kronos Konstruksion" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë "Korporata Elektroenergjitike Shqiptate (Sh.a. KESH)" për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike në digën e Zadejës.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë "Bushtrica 2017" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Bushtrica 2".
5. Mbi kërkesën e shoqërisë "Gerti" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë "Albpower" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë "G.S.K" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
8. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e Rregullores për Rregullat dhe Procedurat e Regjistrimit, Administrimit të Regjistrimit dhe Pezullimit të Statusit të Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme

9. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e Marrëveshjes Tip për Anëtarësimin në Komunitetin e Energjisë së Rinovueshme

10. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI